

Shërbimi Wizz FTP – Rregullat dhe kushtet

Me pagesën për shërbimin Wizz FTP ju deklaroni dhe pranoni se jeni informuar siç duhet, keni kuptuar dhe keni pranuar shprehimisht këto rregulla dhe kushte.

1 INTERPRETIMI

- 1.1 Rregullat dhe kushtet që tregohen te Kushtet e Përgjithshme të Transportit të Wizz Air (**GCC**) kanë të njëjtin kuptim si këto rregulla dhe kushte (**Terms and Conditions, TC**) përveç nëse më poshtë ose në kontekst kërkohet ndryshe.
- 1.2 Dispozitat e TC do të kenë përparësi në rast se ka ndonjë mospërputhje mes GCC dhe këtyre TC.

2 PËRKUFIZIMET

- 2.1 **Aplikacioni:** Aplikacioni celular Wizz Air i lidhur me Uebsajtin dhe i operuar nga ose për Wizz Air ku mund të bëhen rezervimet.
- 2.2 **Rezervim:** një rezervim për një ose më shumë fluturime të Wizz Air (me çdo shërbim shtesë, nëse zbatohet) që konfirmohet si i pranuar nga Wizz Air. Rezervimi shërben si bazë e kontratës për transportin ajror mes klientit, pasagjerit(ëve) dhe Wizz Air.
- 2.3 **Klienti** ose **ju:** personi që blini shërbimin Wizz FTP.
- 2.4 **Kushtet e përgjithshme të transportit** ose **KPT:** kushtet e përgjithshme të transportit të Wizz Air siç publikohen në faqen e internetit dhe ndryshohen herë pas here nga Wizz Air.
- 2.5 **Pasagjer:** personi që përdor shërbimet e transportit ajror të pasagjerëve të Wizz Air dhe emri i të cilit jepet si pasagjer gjatë rezervimit nga klienti.
- 2.6 **Uebsajti:** www.wizzair.com.
- 2.7 **Wizz Air:** Wizz Air Hungary Ltd (selia e regjistruar: H-1103 Budapest, Kőér street 2/A, Building B, Floors II-V Hungary), Wizz Air UK Ltd (selia e regjistruar: Main Terminal Building, London Luton Airport, Luton, LU2 9LY, United Kingdom), Wizz Air Malta Ltd (selia e regjistruar: 171, Old Bakery Street, Valetta VLT-1455, Malta), Wizz Air Abu Dhabi LLC (selia e regjistruar: Business Park 01, Plot P6, Office number 208, Abu Dhabi International Airport, Abu Dhabi, United Arab Emirates) ose çdo ent tjetër i Wizz Air i cili operon fluturimin që rezervohet nga pasagjeri nën markën e Wizz Air.
- 2.8 **Tarifa e shërbimit të Wizz FTP:** tarifa e shërbimit që jeni të detyruar të paguani për shërbimin Wizz FTP. Shuma e tarifës së shërbimit Wizz FTP tregohet në faqen e internetit.
- 2.9 **Shërbimi Wizz FTP:** shërbimi plotësues që ofrohet nga Wizz Air sipas këtyre TC dhe GCC. Ky shërbim ndihmës – kundrejt tarifës së shërbimit Wizz FTP – i jep klientit në mënyrë të njëanshme të drejtën për të modifikuar kontratën e transportit të pasagjerëve në rrugë ajrore mes klientit, pasagjerit(ëve) dhe Wizz Air, e cila u nënshtrohet GCC dhe ligjeve e rregullave të tjera të zbatueshme duke treguar / ndryshuar emrin(at) e pasagjerit(ëve) në përputhje me këto TC pa paguar tarifën për ndryshimin e emrit.

3 BLERJA E SHËRBIMIT WIZZ FTP

- 3.1 Ju mund të blini shërbimin Wizz FTP në faqen e internetit duke ndjekur identifikimin në llogarinë tuaj Wizz. Shërbimi Wizz FTP mund të blihet me check-in online dhe nëse jepet të paktën emri i një pasagjeri pas kryerjes së rezervimit dhe pas marrjes së konfirmimit të rezervimit.

- 3.2 Nëse keni blerë shërbimin Wizz FTP, mund ta bëni rezervimin pa treguar emrin(at) e çdo pasagjeri (pra, pa qenë nevoja për të dhënë emrat e më shumë se një prej pasagjerëve, siç tregohet te pika 3.1). Megjithatë duhet të jepni emrat e të gjithë pasagjerëve online jo më vonë se 3 (tre) orë para orarit të planifikuar të nisjes së fluturimit. Gjithashtu mund të ndryshoni emrin(at) e pasagjerit(ëve) pas rezervimit në çfarëdo kohe pasi të jetë bërë check-in.
- 3.3 Nëse nuk tregoni emrin e pasagjerët(ëve) brenda kohës që tregohet në pikën 3.3, kjo do të konsiderohet si anulim i rezervimit nga ju në lidhje me pasagjerin(ët) për të cilët nuk është dhënë emri, dhe kjo u nënshtrohet dispozitave të GCC për anulimin.

4 PAGESA E TARIFËS SË SHËRBIMIT WIZZ FTP

- 4.1 Tarifa e shërbimit Wizz FTP ka afat dhe është e mundur të paguhet në kohën e rezervimit.
- 4.2 Shërbimi Wizz FTP mund të blihet vetëm duke u bazuar vetëm për një pasagjer për një fluturim (një nga një). Në rastin e blerjes së një fluturimi kthimi, blerja e shërbimit Wizz FTP aplikohet automatikisht për fluturimin vajtje dhe ardhje, ndaj tarifa e shërbimit Wizz FTP do të llogaritet në bazë të numrit të pasagjerëve dhe numrit të fluturimeve.

5 KUFIZIMET DHE LIMITIMET

- 5.1 Pasi të përfundojë check-in, nuk mund t'i ndryshoni emrat e pasagjerëve pa paguar tarifën e ndryshimit të emrit. Kjo nuk vlen për kërkesat për të verifikuar edhe një herë të dhënat personale të pasakta nëse korrigjimi i kërkuar nuk përfshin ndryshimin e një pasagjeri. Mund ta shihni tarifën për ndryshimin e emrit në faqen tonë të internetit.
- 5.2 Shërbimi Wizz FTP nuk disponohet për rezervimet në grup.
- 5.3 Shërbimi Wizz FTP nuk disponohet për foshnjat ose pasagjerët që kanë nevojë për ndihmë të veçantë. Nëse planifikoni të udhëtoni me një foshnjë ose pasagjer që ka nevojë për ndihmë të veçantë, duhet të jepni emrat e tyre kur bëni rezervimin.

6 ANULIMI NGA WIZZ AIR

- 6.1 Pasi të bëhet rezervimi, tarifa e shërbimit Wizz FTP nuk do të rimbursohet. Megjithatë, pasagjeri(ët) kanë të drejtën për rimbursim nëse Wizz Air e anulon fluturimin para se të bëhet check-in.
- 6.2 Wizz Air do të përdorë atë metodë pagese për rimbursimin që ju keni përdorur për pagesën fillestare.

7 TË NDRYSHME

- 7.1 Të gjitha promocionet, tarifat e fluturimit dhe ofertat e tjera speciale të ofruara nga Wizz Air u nënshtrohen kushteve të përgjithshme që i përkasin asaj oferte.
- 7.2 Shërbimi Wizz FTP nuk duhet të ofrohet për qëllime tregtare nga klienti, pasagjeri ose nga ndonjë palë e tretë, duke përfshirë, ndër të tjera, ankandet në internet ose në platforma të tjera në ueb.
- 7.3 Wizz Air nuk është përgjegjës për asnjë dëmtim që lind nga çfarëdo lloj keqpërdorimi nga palë të treta të pavarura i shërbimit Wizz FTP ose nga humbja apo zbulimi që i bëhet kujt do tjetër përveç klientit dhe pasagjerëve.
- 7.4 Wizz Air rezervon të drejtën për të ndryshuar në mënyrë të njëanshme këtë KP në çdo kohë duke publikuar KP-në të ndryshuar në faqen e internetit. Përveç siç përcaktohet ndryshe këtu për sa u përket rezervimeve të bëra ose shërbimeve të blera në faqen e internetit, zbatohet GCC e entit të Wizz Air që operon fluturimin.
- 7.5 Këto TC janë në fuqi derisa të bëhet anulimi i tyre.

Në fuqi nga: 15 gusht 2023